
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	ZYRA E PERSONELIT KANCELARIJA OSOBLJA		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.54/18	Data: 20.04.2018	

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës, Komuna e Istogut ,shpall:

K o n k u r s

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

Vendi i punës: Zjarrfikës (Njësia e Zjarrfikësve)

Drejtorati : Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

Numri i Ekzekutuesve: 2 (dy)

Paga mujore: 350 € në muaj

Kohëzgjatja e Emrimit : Me afat të caktuar – 5 (pesë) muaj

Orari i plotë : 40 orë në javë

Detyrat :

- Merr pjesë në intervenimet për fikjen e zjarrit dhe intervenime të tjera;
- Kujdeset për pajisje dhe mjetet e përdorura gjatë intervenimit;
- Kujdeset për ruajtjen e pasurisë gjatë intervenimit, kur nuk është pronari i pranishëm;
- Rregullisht vijon trajnimet (ushtrimet e caktuara);
- Kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pajisjes dhe mjeteve kolektive dhe personale;
- Kryen dhe respekton të gjitha urdhëresat e udhëheqësit të ndërrimit, komandantit ose zëvendësit, përveç atyre urdhëresave të cilat do të ishin vepër kundërvajtës ose penale;
- I kryen edhe detyrat tjera të parashtruara nga eprori;

Kushtet për punësim :

- Përgatitja e mesme shkollore;
- Të ketë të përfunduar trajnimin bazik për zjarrfikës;
- Përparësi do të kenë personat që kanë përvojë pune si zjarrfikës;
- Të ketë aftësi psiko-fizike për të kryer aktivitetet e zjarrfikës dhe
- Të mos jetë i ndjekur penalisht

Dokumentacioni i nevojshëm;

- Kopja e dokumentacionit të kualifikimit(diploma e shkollës së mesme),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Çertifikata e lindjes apo ekstrakti i lindjes,
- Dy rekomandime,
- Dëshmi për aftësi psiko-fizike për të kryer aktivitetet e zjarrfikjes,
- Dëshmi qe nuk jeni i ndjekur penalisht.

Data e shpalljes së konkursit: 20.04.2018 deri më datë 27.04.2018

Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu qysh parashihet me Ligjin nr.03/L-212 të Punës.

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra Nr. 100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

Afati i aplikimit është 8 ditë, nga shpallja publike në tabelen e shpalljeve dhe në Web faqe të Komunës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.



Menaxheri i Peronelit
Fatmir Bytyçi